

## Argo



ADITIV

**Vonues tharjeje për një lyerje perfekte me vernik**

Ngadalësues tharje. Argo rrit aftësinë miqësore të përpunimit të verniqeve ujore LOBA dhe minimizon qartë rrezikun e depozitimin.

- Redukton rrezikun e formimit të depozitimeve
- Veçoritë e shtresës së vernikut nuk ndryshojnë

**Gama e përdorimit:**

I përshtatur në mënyrë optimale për LOBA me bazë uji.

## Të dhëna teknike të produkteve

NR. ARTIKULLI		
11015	250 ml	12

<b>Viskoziteti</b>	13 ±2s
<b>Magazinimi dhe transportimi</b>	24 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit, merrni parasysh mbishkrimin e kutisë. Depozitim dhe transportim në temperatura +5°C deri +25°C. Mbrojeni nga ngrica. Material i parrezikshëm sipas ADR.

## Udhëzime përpunimi

- Argo mund t'u shtohet të gjithë verniqeve të ujit LOBA. Sasia e shtimit maks. 5%. Në një kuti (250 ml) Argo përziehen 5 l (5 kg) vernik.
- Tundni mirë materialin.
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në [www.wingis-online.de](http://www.wingis-online.de).

**KOHA E THARJES**

- Koha e tharjes përpara se boja e përzier të mund të kalohet, të lyhet dhe të lëmohet në mes është rreth 50% më e gjatë në varësi të kushteve të dhomës. Koha e tharjes deri në qëndrueshmëri e plotë mbetet e pandryshuar.

**PËRPUNIMI:**

Aditivi të shtohet menjëherë para aplikimit dhe të tundet ose të përziehet mirë. Te sistemet me dy komponentë, shtimi të bëhet pas përpunimit të masës së fortë në masë! Verniku 1K i përzier me aditiv duhet të përpunohet brenda 24 orëve, verniku 2K brenda kohës së dhënë të përpunimit. Nuk garantohet një stabilitet më i gjatë në magazinim përtej kësaj.

## Udhëzime të përgjithshme

**Pastrimi i mjeteve të punës:** Pastroni mjetet e punës me ujë menjëherë pas përdorimit.

**Koha e tharjes:** Koha e tharjes e përmëndur është e vlefshme për temperaturë +20°C dhe lagështi relative të ajrit 50%, si dhe ajrosje të vazhdueshme të ambientit të punës, pa rryma ajri. Temperaturat më të ulta, lagështia relative e lartë, mosajrosja e duhur vonojnë tharjen. Pa arritur forcimin (tharjen) e plotë mos pastroni dhe mos shtroni tapete. Për mbulimin e sipërfaqes para tharjes së plotë përdorni LOBA Cover 400. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

**Rrashnim i ndërmjetëm:** Në rastin e aplikimit të disa shtresave verniku, për arritjen e aderimit të mjaftueshëm të shtresës së ndërmjetme, lyerja e shtresës që pason bëhet brënda 24 orëve pa rrashnim të ndërmjetëm. Me rrashnim të ndërmjetëm para aplikimit të shtresës së fundit arrihet një sipërfaqe e njëtrajtshme. Pastroni me kujdes pluhurin pas çdo rrashnim të ndërmjetëm.

**Përdorim i astarit apo punim vetëm me vernik:** Përdorimi i astarit rrit sigurinë e përpunimit dhe garanton një sipërfaqe pa shenja dhe vijëzime, pothuajse në çdo rast pavarësisht llojit të drurit. Më shumë detaje gjenden në listën me llojet e drurit LOBA te katalogu në fjalë.

**Ngjitje e anëve:** Sistemet e bojrave me bazë ujin në përgjithësi kanë tendencë për ngjitje të cepave. Për të reduktuar formimin e lidhjeve të parregullta dhe ngjitjen e mëvonshme të elementeve këshillohet marrja e masave paraprake si: ngjitje e qëndrueshme elastike ose kundër shtytëse e elementeve të parketit, mbushje të kujdesshme e fugave me stuko, përdorim i astarëve të përshtatshëm si p.sh. LOBA EasyPrime, trajtimi paraprak i anëve të zbrazta të parketeve prej druri solid me dyll të përputhshëm me bojën, para instalimit. Po ashtu, marrja e masave të cilat do ruajnë një klimë të qëndrueshme në dhomë dhe veçanërisht lagështinë relative të ajrit. (Rekomandohet informimi me kujdes i klientit). Veçanërisht të ndjeshme janë dyshemetë e vjetra të dëmtuara ose të paqëndrueshme, parketet prej druri me ngjitje elastike ose të gozhduara, parketet me dërrasa druri, dyshemetë me veshje druri, parketet laminate, parketet mbi dysheme me system ngrohje, drurët me kohë të shkurtër ndryshimi të lagështirës si ahuj, panja.

**Ndërveprime:** Materiale të tilla si p.sh. nënshtresat e tapeteve, këmbët dhe rrotat e mobiljeve, ngjitësat elastikë për ngjitje ose fiksime të parketeve mund të shkaktojnë zbutje dhe çngjyrosje. Materiale ndërtimi të lëna mbi lidhjet mund të ndikojnë negativisht në prekje dhe në pamje. Ekspozimi në bojra floku, goma makinash, motorash, biçikletash, gjithashtu mund të shkaktojnë çngjyrosje të përhershme dhe të pandryshueshme të sipërfaqes.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speciale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve. Detyrimet dhe përgjegjësia janë përcaktuar ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

Fjalët dhe simbolet me shenjen ® përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.